

VENDIM
Nr. 83, datë 9.2.2022

**PËR KALIMIN TE BASHKIA LEZHË DHE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
TË NJËSIVE TË BANIMIT TË SHËRBIMIT DHE NJËSIVE TË NDËRTIMIT
NËNTOKË, NË BASHKINË LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Lezhë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), si dhe njësive të ndërtimit nëntokë, sipas listës së inventarit, dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Kalimin te Fondi Shqiptar i Zhvillimit të njësive të shërbimit në ndërtesat (pallat), sipas listës së inventarit, dhënë në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1
(PARKIME DHE BANIM APARTAMENTE)

Nr.	Emërtimet	Sipërfaqe ndërtimi nëntokë (m ²)	Sipërfaqe banimi (m ²)	Tipologjitë e apartamenteve			
				Ap. 1+1	Ap. 2+1	Ap. 3+1	Total, apartamente
1	Objekti 01	1,884.72	9,171.85	39	38	20	97
TOTALI		1,884.72	9,171.85	39	38	20	97

ANEKSI 2
(SHËRBIME)

Nr.	Emërtimet	Sipërfaqe shërbimesh (m ²)	Njësi shërbimesh (copë)
1	Objekti 01	1,079.65	5
TOTALI		1,079.65	5